



Konferenca e 2-të Ndërkombëtare "Globalizimi dhe Integrimi në Edukimin Bashkëkohor"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani", u zhvillua Konferenca e 2-të Ndërkombëtare me temë "Globalizimi dhe Integrimi në Edukimin Bashkëkohor".

Kjo konferencë e organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit është kthyer tashmë në një traditë, ku mbledhen së bashku studiues nga fusha e arsimit, akademikë, drejtues dhe mësues të sistemit arsimor parauniversitar, specialistë dhe studentë.

Në fjalën e tij përshëndetëse rektori i universitetit, Prof.dr Skender Topi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve në fushën e arsimit dhe rolin që ka luajtur prej vitesh ndërkombëtarizimi në rritjen e cilësisë si institucion i arsimit të lartë.

Konkursi i Punimeve Kërkimore



CleanScore shpalli fituesit e edicionit të tretë të "Konkursi i Punimeve Kërkimore". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm pedagogë, studentë, përfaqësues nga zyrat e karrierës, fituesit e edicioneve të mëparshme si dhe pjesëmarrësit e këtij edicioni. Finalja e këtij konkursi solli 33 punime cilësorë nga universitete pu like dhe privat. Risi e këtij edicioni ishte pjesëmarrja e konkurrentëve nga diaspora. Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani", u përfaqësua nga studentja, Argesta Stërğu, e cila fitoi çmimin e tretë.

Forumi "Toleranca përtej kulturës"



Universiteti "Aleksander Xhuvani", organizon për herë të parë forumin me temë "Toleranca Përtej Kulturës". Ky forum, vjen si rezultat i bashkëpunimit midis Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", Fondacionit Ndërkombëtar për Tolerancën dhe Research Dialogue Cooperation. Në fjalën e tij përshëndetëse, rektori i universitetit, Prof.dr Skender Topi, theksoi rëndësinë e krijimit të aktiviteteve kushtuar tolerancës dhe kulturës, duke përmendur gjithashtu projektet e ndërmarra së fundmi, për njohjen e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere, duke mundësuar kështu rritjen e cilësisë akademike të studentëve. Përgjatë takimit, për të ftuarit u shpërndanë dhe çmime vlerësimi.

Konferenca Vjetore Shkencore Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan



Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani", merr pjesë për të dytin vit radhazi në Konferencën Vjetore Shkencore Ndërkombëtare të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Kosovë. Në konferencën me temë "Identiteti Shkencor dhe Kreativiteti në një Botë të Ndryshuar", u ofrua pjesëmarrja me prezantime të rezultateve të kërkimit në një nga 5 seksionet e konferencës:

- 1) Sfidat aktuale në dixhitalizim
 - 2) Kërkimet aktuale në matematikë
 - 3) Sfidat aktuale në arsimin shkollor
 - 4) Mundësitë dhe sfidat për Zhvillimin Ekonomik
 - 5) Drejtësia pozitive dhe shteti ligjor
- Konferenca është kthyer në një vend takimi dhe platformë për studiues, mësues edukatorë dhe politikëbërës nga rajoni dhe e gjithë bota.



Takim me ambasadoren e Greqisë në Shqipëri, Znj. Sophia Philippidou

Rektori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof.dr Skender Topi, mirëpriti në një takim ambasadoren e Greqisë në Shqipëri, Znj.Sophia Philippidou.

Prof.dr Skender Topi, shprehu falenderimin e tij, për mundësimin e këtij takimi dhe u ndal në projektet dhe marrëveshjet e ndërmarra, për zhvillimin dhe rritjen e cilësisë së institucionit në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Znj. Sophia Philippidou, vlerësoi iniciativën e Prof.dr Skender Topi, për rritjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë në Greqi dhe shprehu gatishmërinë për krijimin e urave të bashkëpunimit në fushën akademike.

Në takim, u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit me universitetet në Greqi, për të forcuar marrëdhëniet mes dy palëve, me qëllim shkëmbimin e studentëve, personelit akademik, mundësimin e programeve të përbashkëta, projekte për ngritjen e kapaciteteve, organizimin e konferencave dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor.

Komisioni parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik



Komisioni parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik, zgjedh Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për mbledhjen e tij të radhës.

Në një bashkëbisedim me Rektorin e Universitetit, Prof.dr. Skender Topi dhe personelin akademik, u diskutua mbi problematikat që shoqërojnë sot programet e studimit të mësuesisë dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre, mbi çështjet e titujve dhe gradave shkencore, zhvillimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor etj.

"Integrimi i studentëve në tregun e punës"



Në kuadër të projektit "3E - English-Entrepreneurship - Employability", mundësuar nga mbështetja e Ambasadës Amerikane, JAA (Junior Achievement Albania), zhvilloi në Universitetin e Elbasanit tryezën me temë "Integrimi i studentëve në tregun e punës".

Znj. Blerina Guga dhe Znj.Anisa Subashi, prezantuan situatën aktuale të punësimit të studentëve dhe identifikimin e modeleve dhe praktikave kombëtare e lokale, që mundësojnë integrimin e studentëve në tregun e punës.

Sesion informues nga Z.Denis Gafuri



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit UE, organizoi aktivitetin e fundit për këtë vit akademik me studentët e Fakultetit Ekonomik.

Ne aktiviteti mori pjesë Z. Denis Gafuri, folës ndërkombëtar, autor i librit të suksesshëm "Suksesi në Shitje", sipërmarrës dhe gjithashtu themelues i Konventës Internacionale të Biznesit dhe Sipërmarrësve.